



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR, BLEGTORAL, PYJEVE, MJEDISIT DHE**  
**KONTROLLIT TË USHQIMIT**

Nr. 572/Prot  
1

Patos më 23/02 2023

**RELACION**  
**PËR**  
**NGRITJEN E NJË TREGU PËR SHITJEN E FRUTA PERIMEVE**

Në mbështetje të nenit 28 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” një nga funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor është ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.

**VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZONËS**

Bashkia Patos është pjesë e qarkut të Fierit ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit. Me një sipërfaqe 82.5 km<sup>2</sup>, territori i Bashkisë Patos përfshinë nën juridiksionin e saj dy Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdië të përbërë nga 18 fshatra, me një popullsi totale 44.502 banorë. Aktiviteti ekonomik kryesor është bujqësia dhe blegtoria me 35% të punësuar ose rreth 15,487 persona. Bashkia Patos ka një pozitë të favorshme për biznesin edhe tregtimin e produkteve bujqësore duke qënë se është në afërsi të rrugëve nacionale të cilat kanë sjellë një impakt pozitiv në zhvillimin e zonës dhe përkatësisht rrugët nacionale Fier-Berat dhe Fier-Gjirokastër. Përafërsisht 70% e aktiviteteve bujqësore kryhen në sektorin e bujqësisë kjo për faktin se kushtet klimatike të zonës janë të favorshme për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore si drithrat, ullishtet, vreshtat dhe frutave si në fushë të hapur edhe në sera. Territori i Bashkisë Patos ka një sipërfaqe toke bujqësore rreth 5,990 ha, nga të cilat 47% kanë karakter fushor dhe 53% shtrihen në kodra të ulta. Numri i fermave bujqësore është rreth 3,690 nga të cilat 54 janë të drejtuara nga femra. Deri para 2 viteve shumica e fermave nuk ishin të rregjistruara dhe vetem 178 fermer ishin me NIPT, pas Skemave Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi të vitit 2021 dhe 2022 kemi 769 fermer të rregjistruar. Edhe pse në territorin e bashkisë kemi një rendimint të lartë të prodhimeve bujqësore falë kushteve klimaterike fermerët hasin problem në shitjen e prodhimeve. Shumica e prodhimit që vjen nga serat shkon për eksport e cila kryhet nga pika grumbullimi të cilat ndodhen jashtë territorit të Bashkisë Patos. Fermerët e vegjël që kultivojnë në fushë të hapur dhe kanë sasi më të vogël prodhimi hasen me mungesën e tregut ku mund të shesin prodhimet e tyre. Fruta/ perimet janë prodhime delikate që dëmtohen dhe prishen shpejt, kanë qëndueshmëri të shkurtër pas vjeljes si dhe kërkohen çdo ditë në treg për këtë arsye propozojmë ndërtimin e një tregu për tregtimin e fruta perimeve.

**SEKTORI I FRUTA PERIMEVE**



Sektori i fruta perimeve konsiderohet si një industri me kërkesa konsumatore të qendrushme, e cila siguron të ardhura ekonomike të vazhdueshme dhe që në raport me industrinë e tjera është më rezistente ndaj periudhave të reëensionit. Prodhimi i fruta perimeve është i lidhur ngushtë me bujqësinë, duke vepruar si furnizues i lëndës së parë për një pjesë kryesore të kësaj industrie. Objektivat kryesore të kësaj industrie në vendin tonë janë:

- Rritja e prodhimit;
- Modernizimi i prodhimit dhe zgjerimi i kapacitetit prodhues;
- Zhvillimi i logjistikës dhe infrastrukturës së tregut të ushqimit;
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së produkteve me qëllim zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksporteve.

Sektori i fruta perimeve, është një degë shumë e rëndësishme e bujqësisë, dhe si e tillë produktet e këtij sektori kalojnë të gjitha proceset dhe shërbimet që dikton kjo industri.

## **REZULTATET E PRITSHME**

Ndërtimi i tregut do të ndikojë për të:

### **1.Siguruar përkrahje për industrinë agropërpunuese;**

Mungesa e industrisë agropërpunuese vihet re për shkak se në të gjithë territorin e bashkisë janë 1 baxho e gjendur në fshatin Zharrëz, 1 fabrikë përpunimi të produkteve bujqësore në Sheqishte si dhe 8 pika përpunimi të ullirit të cilat janë në Gjinoqarë, Ruzhdië, Rrerës dhe Kuqar. Me ndërtimin e tregut do të nxitej rritja e prodhimit të brendshëm dhe si rrjedhojë do sillte shtimin e agropërpunuesëve gjë e cila do të na çonte prodhimin në një cikël të mbyllur.

### **2.Mbështetur prodhimet e fermerëve;**

Fermerët do kenë më shumë mundësi reale për të shitur produktet e tyre direkt te konsumatori pa u dashur ndërhyrja e tregtarëve gjë që mund të ulte ndjeshëm fitimet e fermerëve. Rritja e nivelit ekonomik të familjeve bujqësore do të sjellë cilësi më të lartë jetese në zonat rurale, si dhe do të sillte perfshirjen e më shumë sipërfaqe toke të punueshme edhe të mbjellë me produkte bujqësore.

### **3.Siguruar mbrojtjen dhe sigurinë ushqimore për konsumatorin.**

Ndërtimi i tregut afër zonave ku ato prodhohen rrit mundësinë që konsumatori në tryezen e tij të ketë produkte cilësore dhe me një siguri më të lartë ushqimore. Gjithashtu produktet nuk do duhet që të transportohen për një kohë të gjatë si ndodhë me produktet e importit që vijnë në kontenier të mbyllur gjë që i ekspozon ndajë kushteve klimaterike të zonave në të cilat kalon që sjell edhe uljen e cilësisë së produktit.

Kërkohet ngritja e një tregu në rrugën nacionale Fier- Berat në Njësinë Administrative Zharrëz brenda kufirit të përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor , aty ku bujqësia intensive është më e përqëndruar. Ky treg mendohet të jetë sezonal gjatë muajve Prill-Nëntor ku kemi dhe më tepër prodhime.

## **OBJEKTIVAT E PROGRAMIT IPARD**

- Mbështetja e investimeve në sektorin agro-ushqimor me qëllim përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit;
- Mbështetja e investimeve në zonat rurale me qëllim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e biznesit, duke çuar në përmirësimin e mundësive të punësimit dhe përfshirjes sociale.

Misioni i AZHBR-së, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE është zhvillimi Agrikulturor dhe Rural në Shqipëri, duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurrese të vendit.

Sp.i Zhvillimit Rural  
Marjus **SHABANAJ**



Drejtori  
Orges **GOLLOSHI**

